



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Drejtoria e Edukimit Parauniversitar

9170/
Nr. ... Prot.
2

Tiranë, më 25 . 11. 2010

LËNDA: RREGULLORE E KUALIFIKIMIT TË DREJTUESVE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

DREJTUAR: Z/ZJ.....
Drejtor i DAR/ZA

I Nderuar Z/Zj.....

Ju dërgojmë bashkangjitur Udhëzimin Nr 36, datë 22.11.2010, për Kualifikimin e Drejtuesve të Institucioneve Parashkollorë dhe Shkollave , si dhe Rregulloren për Kualifikimin e Drejtuesve të Institucioneve Arsimore.

SKËNDER UKU
SEKRETART PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 7170 Prot.

Tiranë, më 22.11 2010

UDHËZIM

Nr. 36, datë 22.11 2010

PËR
KUALIFIKIMIN E DREJTUESVE TË INSTITUCIONEVE
PARASHKOLLORE DHE SHKOLLAVE

Në mbështetje të neneve 119 dhe 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”, të ligjit Nr. 8387, datë 30.07.1998 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”, udhëzoj:

1. Duke filluar nga viti shkollor 2010-2011 të zhvillohen procedurat e kualifikimit të drejtuesve të institucioneve parashkollore dhe shkollave publike dhe ato private në përputhje me Rregulloren e Kualifikimit të Drejtuesve të Institucioneve shkollore dhe parashkollore.
2. Ngarkohen për hartimin e programit të kualifikimit Instituti Kombëtar i Zhvillimeve Arsimore (IZHA), Drejtoria e Edukimit Parauniversitar në MASH, njësia përgjegjëse për politikën e burimeve njerëzore në MASH.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, njësia përgjegjëse për politikën e burimeve njerëzore në MASH, IZHA dhe DAR-et.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ


MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Nr. ... Prot.
1

Tiranë, më 22.11 / 2010

**RREGULLORE E KUALIFIKIMIT TË DREJTUESVE TË
INSTITUCIONEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të neneve 119 dhe 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar” i ndryshuar, Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton këtë Rregullore të Kualifikimit të drejtuesve të institucioneve arsimore.

Neni 1

Fusha e veprimit të kësaj Rregulloreje

Kjo Rregullore përshkruan procedurat e kualifikimit të drejtuesve (drejtor; nëndrejtor) të institucioneve arsimore publike dhe ato private që më poshtë do të quhen “drejtues”.

Neni 2

Llojet e certifikatave të drejtuesit

Certifikatat e drejtuesit janë dy llojesh:

- 1) Certifikata e drejtuesit për institucionet parashkollore,
- 2) Certifikata e drejtuesit për institucionet e arsimit bazë dhe ato të arsimit të mesëm (gjimnazi, shkollat profesionale dhe socialkulturore).

Neni 3

Raste të veçanta

Lejohen të hyjnë në provimin e kualifikimit pa marrë pjesë në trajnime, nëse dëshirojnë:

- 1) personat që kanë kryer studime universitare të ciklit të dytë ose të tretë në fushën e drejtimit, administrimit dhe menaxhimit të arsimit në shkolla të larta të akredituara;
- 2) personat që ushtrojnë detyrën e drejtorit të institucionit arsimor për të paktën 5 vite të plota shkollore të njëpasnjëshme deri në datën e nxjerrjes së Udhëzimit të Ministrisë për kualifikimin e drejtuesve;
- 3) personat që kanë ushtruar detyrën e drejtorit të institucionit arsimor për të paktën 10 vite të plota shkollore jo të njëpasnjëshme deri në datën e nxjerrjes së Udhëzimit të Ministrisë për kualifikimin e drejtuesve.

Neni 4

Kriteret për të kandiduar për drejtues

1. Aplikon për të fituar certifikatën e drejtuesit personi që:
 - a) ka kryer studime universitare të ciklit të dytë ose të tretë në fushën e drejtimit, administrimit dhe menaxhimit të arsimit,ose,
 - b) ka marrë diplomën e mësuesit sipas kriterëve të nivelit përkatës të arsimit, ka të paktën kategorinë e tretë të kualifikimit të mësuesve dhe në provimin e kualifikimit të mësuesve është vlerësuar me të paktën “mirë”.
2. Personat të cilët aplikojnë për certifikatën e drejtuesit:
 - a) nuk duhet të jenë në proces administrativ ose penal,
 - b) duhet të paraqesin dy rekomandime pozitive nga eprorë të drejtpërdrejt me të cilët ka punuar gjatë pesë viteve të fundit.

Neni 5

Programi i kualifikimit të drejtuesve

1. Programi i kualifikimit të drejtuesit bazohet në standardet kombëtare të drejtuesit të institucioneve arsimore.
2. Programi i kualifikimit të drejtuesit synon të pajisë pjesëmarrësit me dijet, shprehitë dhe kompetencat e nevojshme për të ushtruar detyrën e drejtuesit sipas parimeve dhe praktikave më të suksesshme bashkëkohore.
3. Programi i kualifikimit të drejtuesve
 - a) hartohet nga IZHA, në bashkëpunim me Drejtorinë e Edukimit Parauniversitar, njësi përgjegjëse për politikën e burimeve njerëzore në MASH;

- b) miratohet nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.
4. Programi i kualifikimit të drejtuesve hartohet brenda 3 muajve nga data e nxjerrjes së kësaj rregulloreje.
 5. Ndryshimet në programin e kualifikimit të drejtuesve miratohen nga Ministri.
 6. Programi i kualifikimit të drejtuesve përbëhet nga disa module me kreditet përkatëse (1 kredit fitohet kur punonjësi arsimor plotëson afërsisht 25 orë punë për një modul, nga të cilat 5-6 orë janë trajnim ndërsa orët e tjera janë punë individuale ose në grup për përgatitje dhe prezantim projekti, eseje, studime, zbatime në shkollë etj).

Neni 6

Parimet kryesore të trajnimit të kandidatëve për drejtues

Parimet kryesore të trajnimit janë:

- 1) Agjenci të ndryshme trajnuese konkurrojnë për programin e kualifikimit të drejtuesve ose për module të veçanta të tij.
- 2) Komiteti i Akreditimit të Trajnimit akrediton programin ose module të veçanta të tij.
- 3) Kandidatë për drejtues përzgjedhin agjencinë trajnuese me të cilën do të zhvillojnë trajnimet për programin e kualifikimit në tërësi ose për module të veçanta të tij.

Neni 7

Format e trajnimit

Trajnimet zhvillohen në tri forma:

- 1) “Trajnimi tradicional” kur trajneri zhvillon seanca trajnuese drejtpërdrejt me të trajnuarit;
- 2) Trajnimi “On-line dhe i kombinuar me konsultime” kur agjencia trajnuese e vendos përmbajtjen e moduleve në një faqe interneti dhe ofron konsultime me punonjësit arsimorë;
- 3) Trajnimi “Vetëm on-line” kur agjencia trajnuese e vendos përmbajtjen e moduleve në një faqe interneti;

Neni 8
Certifikimi i kandidatit për modulën

- 1) Kandidatët për drejtues i nënshtrohen provimeve të veçanta për çdo modul të programit të kualifikimit.
- 2) Provimet zhvillohen nga agjencia përkatëse trajnuese.
- 3) Provimi për një modul është me shkrim.
- 4) Agjencia trajnuese pajis kandidatin fitues në provimin e një moduli me certifikatën e cila përmban numrin e krediteve, rezultatin e kandidatit në provim dhe të dhëna për modulën.

Neni 9
Vlerësimi i kandidatit në provimin e modulit

- 1) Në vlerësimin me pikë të një kandidati për një modul agjencia trajnuese llogarit:
 - a. Vlerësimi me pikë i portofolit,
 - b. Vlerësimi me pikë i testit.
- 2) Për çdo modul, secili kandidat përgatit portofolin i cili përbëhet nga detyra tematike, raste studimore, projekte, esse etj, sipas kërkesave nga agjencia trajnuese.
- 3) Agjencia trajnuese vlerëson portofolin me 20% të pikëve të modulit.
- 4) Testi për një modul përmban njohuri teorike dhe zbatime praktike të këtyre njohurive.
- 5) Njohuritë teorike të testit vlerësohen me 40% të pikëve të modulit dhe ato për zbatimet praktike me 40% të pikëve të modulit.
- 6) Vlerësimi i kandidatit është me pesë shkallë: A; B; C; D; E që i korrespondon vlerësimit me fjalë “shkëlqyeshëm”; “shumë mirë”, “mirë” “mjaftueshëm”, “dobët”.
- 7) Kandidati me vlerësimin E (“dobët”) nuk e fiton modulën përkatës.
- 8) Kandidati ka të drejtë të rihyjë në provimin e një moduli vetëm kur është vlerësuar E (“dobët”).

Neni 9
Provimi i kualifikimit të drejtuesve

- 1) Një kandidat, që ka fituar provimet e të gjitha moduleve të programit të kualifikimit, ka të drejtë të marrë pjesë në provimin përfundimtar të kualifikimit për drejtues.
- 2) Provimi i kualifikimit për drejtues organizohet nga Komisioni i Provimit të Kualifikimit të drejtuesve ("Komisioni").
- 3) Komisioni ngrihet me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
- 4) IZHA, në bashkëpunim me Komisionin, harton rregulloren e zhvillimit të provimit të kualifikimit të drejtuesve.
- 5) Rregullorja e zhvillimit të provimit të kualifikimit të drejtuesve miratohet nga Ministri.

Neni 11
Afati i fillimit të provimit të kualifikimit

- 1) Provimi i kualifikimit të drejtuesve zhvillohet mbas 1 viti të hyrjes në fuqi të rregullores së kualifikimit të drejtuesve.
- 2) Provimi i kualifikimit zhvillohet një herë në vit.
- 3) Data e zhvillimit të provimit të kualifikimit të drejtuesve caktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Neni 12
Vlerësimi i kandidatit në provimin e kualifikimit

- 1) Në vlerësimin me pikë të një kandidati në provimin e kualifikimit të drejtuesve llogariten:
 - a. Bonuset (10% e pikëve totale)
 - b. Pikët e testit (90% e pikëve totale)
- 2) Kandidati fiton pikë bonus sipas këtyre kriterëve:
 - a. Me titull në fushën e edukimit (SHPU, MND, Master shkencor, Master profesional, doktoraturë); (5% të pikëve)
 - b. Gjuha e huaj e mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe për personat që diplomohen mbas vitit 2011, e mbrojtur mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtarisht. (5% të pikëve)

- 3) Testi i provimit të kualifikimit të drejtuesve përbëhet nga aq pjesë sa është numri i moduleve të programit të kualifikimit.
- 4) Secila pjesë e testit vlerëson njohuritë për një modul të caktuar dhe ka një përqindje të caktuar të pikëve totale të testit.
- 5) Kandidati vlerësohet me pikë për çdo pjesë dhe është kalues kur ka siguruar pikët minimale për secilën pjesë.
- 6) Vlerësimi përfundimtar i kandidatit është me pesë shkallë: A; B; C; D; E që i korrespondon vlerësimit me fjalë “shkëlqyeshëm”; “shumë mirë”, “mirë” “mjaftueshëm”, “dobët”.
- 7) Kandidati me vlerësimin E (“dobët”) nuk e fiton certifikatën e kualifikimit të drejtuesve.
- 8) Kandidati ka të drejtë të rihyjë në provimin e kualifikimit të drejtuesve vetëm kur është vlerësuar me E “dobët”.

Neni 13

Certifikata e kualifikimit të drejtuesve

- 1) Një kandidat e fiton certifikatën e kualifikimit të drejtuesit, kur është fitues në provimin përfundimtar të kualifikimit të drejtuesve.
- 2) Certifikata e kualifikimit të drejtuesve firmoset nga Kryetari i Komisionit të Kualifikimit të Drejtuesve dhe Drejtori i IZHA-s.
- 3) Certifikatat kualifikimit të drejtuesve përgatiten nga IZHA.

Neni 14

Vlerësimi i agjencive trajnuese

- 1) Kur të paktën 25% e pjesëmarrësve të një agjencie trajnuese nuk fitojnë provimin e kualifikimit të drejtuesve, agjencisë trajnuese i pezullohet për dy vjet e drejta për të trajnuar kandidatët për drejtues.
- 2) Kjo agjenci aplikon rishtas te Komiteti i Akreditimit.

Neni 15

Emërimi në detyrë i drejtuesit

1. E ndërpresin ushtrimin e detyrës së drejtuesit ose nuk aplikojnë për këtë detyrë:

- a) Kandidatët të cilët nuk fitojnë provimin e një moduli që zhvillohet nga agjencia trajnuese;
 - b) Kandidatët që nuk fitojnë provimin e kualifikimit të drejtuesve;
 - c) Drejtuesit të cilët nuk regjistrohen për trajnime kur u është ofruar mundësia për t'u trajnuar për programin e kualifikimit të drejtuesve.
2. Vazhdojnë ta ushtrojnë detyrën e drejtuesit ose mund të aplikojnë për këtë detyrë personat që ende nuk u është ofruar mundësia për t'u trajnuar për programin e kualifikimit të drejtuesve.

Neni 16
Aspekti financiar

Të gjitha shpenzimet për certifikimin e drejtuesve mbulohen nga vetë kandidatët.

Neni 17
Afati i vlefshmërisë së certifikatës

1. Afati i vlefshmërisë së certifikatës së një drejtuesi është 8 vjet që nga data e marrjes së saj.
2. Drejtuesi e rinovon certifikatën duke iu nënshtruar provimeve për disa module të cilat përcaktohen me Udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

MYQEREM TAJAJ



MINISTËR

